

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2006

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, pasi dëgjoji Raportin për Veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2006, **konstaton se:**

- Veprimtaria e Kontrollit të Lartë të Shtetit është ushtruar në përputhje me kërkesat e nenit 164 të ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” dhe të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1.6.2000.

- Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rritur kontributin e tij në drejtim të përmirësimit të administrimit të financave publike.

Kuvendi vlerëson se Kontrolli i Lartë i Shtetit ka përmirësuar veprimtarinë në drejtim të:

- Përdorimit racional të fuqisë kontrolluese dhe rritjes së efektivitetit të saj, duke e përqendruar atë në subjektet me peshë më të madhe në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, më problematike dhe me risk më të madh.

- Koordinimit të formave të ndryshme të kontrollit, duke i dhënë përparësi zhvillimit të kontrollit vlerësues të veprimtarisë së institucioneve, ndaj kontrollit të ligjshmërisë, rregullshmërisë e atij financiar.

- Përmirësimit të cilësisë së veprimtarisë kontrolluese, nëpërmjet rritjes së profesionalizmit e pavarësisë së kontrollorëve, përmirësimit të procedurave administrative për sigurimin e cilësisë së punës kontrolluese, si dhe mbështetjes së kësaj veprimtarie në standardet kombëtare e ndërkombëtare të kontrollit.

- Përmirësimit të metodologjisë së kontrollit, duke synuar harmonizimin e standardeve të brendshme dhe dokumenteve të tjera të veprimtarisë kontrolluese me metodologjinë e kontrollit të institucioneve homologe të kontrollit në vende të tjera të BE-së.

- Shtimit dhe përmirësimit cilësor të përmbajtjes së masave të rekomanduara ndaj subjekteve të kontrolluara, si dhe përmirësimit të procedurave administrative për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij gjatë kontrolleve të ushtruara në këto subjekte.

- Dhënies së rekomandimeve ndaj institucioneve kompetente për plotësimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore.

- Përdorimit me efektivitet dhe në përputhje me ligjin të fondeve buxhetore të institucionit.

- Zgjerimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucionet kombëtare, organizmat ndërkombëtarë të kontrollit dhe institucionet homologe në vende të ndryshme të BE-së.

Kuvendi kërkon që për vitin 2007 Kontrolli i Lartë i Shtetit të thellojë më tej përvojën e fituar gjatë vitit 2006 e gjatë gjithë veprimtarisë së tij, në këto drejtime:

- Forcimin e mëtejshëm organizativ të institucionit, si dhe përmirësimin e metodologjisë së kontrollit, në përputhje me ritmin dhe dinamikën e zhvillimit të vendit, për t’iu përgjigjur detyrimeve që rrjedhin nga objektivat për t’u integruar në BE dhe NATO.

- Fuqizimin e veprimtarisë kontrolluese, veçanërisht në përdorimin e fondeve të marra hua nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe të financimeve nga donatorë të huaj për investime, duke shfrytëzuar përvojën e institucioneve homologe të kontrollit në vende të tjera.

- Rritjen e bashkëpunimit me subjektet e kontrolluara për zbatimin e rekomandimeve, si dhe të bashkëpunimit me njësitë e kontrollit të brendshëm, për të shmangur mbivendosjet në kontroll dhe për të rritur efektivitetin e veprimtarisë kontrolluese, në përputhje me ligjin “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe me ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

- Rritjen e bashkëpunimit me Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin për përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore, veçanërisht për hartimin e ligjit të ri për financimet e huaja, përmirësimin e legjislacionit të sistemit tatimor dhe të ligjit për urbanistikën.

Kuvendi e konsideron të drejtë kërkesën e Kontrollit të Lartë të Shtetit për shtimin e numrit të punonjësve dhe të burimeve financiare, me qëllim zgjerimin e veprimtarisë kontrolluese mbi përdorimin e fondeve buxhetore në bashkitë dhe komunat. Këtë kërkesë Kuvendi do ta shqyrtojë gjatë diskutimit të amendamenteve në ligjin për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007 dhe të projektbuxhetit të vitit 2008.

Kuvendi i sugjeron Këshillit të Ministrave të shqyrtojë rekomandimet e Kontrollit të Lartë

të Shtetit për përmirësimin e legjislacionit, t'u kërkojë institucioneve shtetërore në varësi të tij rritjen e shkallës së zbatimit të masave disiplinore e administrative të rekomanduara nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si dhe të rrisë rolin dhe autoritetin e njësive të kontrollit të brendshëm.

Kuvendi i kërkon Prokurorisë së Përgjithshme të kryejë deri në fund proceset hetimore për paditë penale të paraqitura nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për të vënë para përgjegjësisë ligjore personat përgjegjës për shkelje të ligjit.

21 mars 2007